



## Lektorium

### 24 Janar – Dita Ndërkombëtare e Edukimit

**Tema:** “Edukimi dhe ndikimi i tij në statusin kulturor, social-ekonomik”.

**Data:** 24. 01. 2020, ora 10.30

**Vendi:** Amfiteatri i F.E.F, UNIKO

**Qëllimi:** Evidentimi dhe promovimi i rolit kryesor, që ka edukimi në përpjekjet e ambiciet për zhvillim e shoqërisë, natyra humane dhe integruese e tij në përpjekje për të pakësuar pabarazitë ekonomike dhe sociale në shoqëri.

#### Objektivat:

1. Pedagogët e Departamentit të Edukimit do të referojnë rreth temës duke evidentuar e promovuar rolin kyç, që ka edukimi në formimin intelektual dhe njerëzor tek të rinjtë.
2. Studentët e programeve që mbulon Departamenti i Edukimit, F.E.F do të angazhohen në diskutim duke sjellë mendimet dhe idetë e tyre në lidhjen me rolin që ka edukimi në jetën e tyre, perspektiva që u ofron studimi në Universitet.
3. Pedagogë dhe studentë në këtë leksion të hapur do të parashtrojnë problematikat që ka procesi i edukimit në ditët e sotme në Shqipëri.

**Përshkrimi:** Në kuadër të 24 Janar-it, Ditës Ndërkombëtare të Edukimit, Qendra Rajonale Rinore, Korçë në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në UNIKO do të zhvillojnë një leksion të hapur me temë “Edukimi dhe ndikimi i tij në statusin kulturor, social-ekonomik”. Ndërsa, studentët do të angazhohen në diskutim duke sjellë mendimet dhe idetë e tyre në lidhjen me rolin që ka edukimi në zhvillimin kolektiv, qëllimeve humaniste dhe natyrën e tij të integruar. Gjithashtu, diskutimi do të ndalet edhe tek problematikat që ka procesi i edukimit në ditët e sotme në Shqipëri duke parashtruar edhe ide për zgjidhjen e tyre.

## **Rezultate të pritshme:**

1. Të rinj të ndërgjegjësuar mbi rolin kryesor, që ka edukimi në përpjekjet e ambiciet për zhvillim kolektiv, natyra humane dhe integruese e tij në përpjekje për të pakësuar pabarazitë ekonomike dhe sociale në shoqëri
2. Evidentimi i problematikave qëhas procesin e edukimit në ditët e sotme në Shqipëri.
3. Parashtrimi i disa ideve për zgjidhjen e problematikave të edukimit sot në Shqipëri.

## **Agjenda**

- + Hapja e veprimtarisë
- + Dr Albina Pajo Edukimi dhe format adekuate të komunikimit
- + Xhensila Mirashi Edukimi i vajzave
- + Prof.asc.Dr Irena Nikaj-Edukimi dhe statusi social-ekonomik i studentëve-PISA 2018
- + Diskutime dhe pyetje nga studentët
- + Përfundime dhe mbyllja e veprimtarisë

Bashkëorganizatorë

Prof.asc.Dr Irena Nikaj  
Përgjegjës i Departamentit të Edukimit

Xhensila Mirashi  
Koordinatorë Projektsh e QRRK-së